



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 856 / Prot.  
3

Tiranë, më 27 / 6 / 2017

VENDIM  
“Për rrëzimin e ankesës”

Nr. 84, datë 27 / 6 / 2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesja, Znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankesën nr. 856 Prot. datë 25.05.2017 ndaj Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

Ankuesja, me datë 27.04.2017 ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesat për informacion dhe dokumentacion si më poshtë:

1. Sa persona janë proceduar penalisht për veprën penale të trafikimit të lëndëve narkotike, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal për vitet 2015, 2016 dhe tremujorin e vitit 2017;
2. Një kopje të kërkesave për gjykim që organi i akuzës ka dërguar në gjykatë të të gjitha rasteve ndaj shtetasve shqiptarë që janë proceduar penalisht për akuzën e Trafikimit të Narkotikëve për vitet 2015, 2016 dhe tremujorin e vitit 2017.

Autoriteti Publik i është përgjigjur kërkuases me shkresën nr. 544/1 Prot., datë 15.05.2017 duke vendosur në dispozicion informacionin statistikor të kërkuar në pikën e parë të kërkesës, për vitet 2015 dhe 2016 dhe duke sqaruar kërkuesen se të dhënat statistikore për tremujorin e vitit 2017 janë duke u përpunuar dhe kontrolluar.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka depozituar ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, përpara marrjes së vendimit, Komisioneri me shkresën nr. 856/1 Prot., datë 07.06.2017 ka kërkuar nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 14.06.2017.

Autoriteti Publik është përgjigjur me shkresën nr. 544/5 Prot., datë 14.06.2017 me anë të së cilës ka sqaruar pozicionin e tij në këtë çështje si dhe i ka vënë në dispozicion Komisionerit

bashkëlidhur korrespondencën e shkëmbyer me kërkuesen. Në shkresë sqarohet se informacioni i kërkuar kufizohet nga e drejta për informim konkretisht gërma a) pika 1, gërma b) dhe dh) pika 2 e nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga shqyrtimi i provave shkresore, Komisioneri konstaton se Autoriteti Publik ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në nenin 3, të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke informuar dhe sqaruar kërkuesen se, informacioni i kërkuar në pikën e dytë të kërkesës, përmban të dhëna personale dhe kërkuësja nuk legjitimohet në kërkimin e saj.

Gjithashtu, referuar provave shkresore konstatohet se, kërkesa nuk ka për objekt dokumentacion publik, por ka për objekt akte procedurale të cilat rregullohen nga ligji nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar i miratuar me shumicë të cilësuar, ç’ka nënkupton se në rastin konkret në hierarkinë e ligjeve, ky ligj prevalon ndaj ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Konkretisht në Nenin 103 të ligjit të sipërcituar, parashikohet ndalimi i publikimit të këtyre akteve.

Pas shqyrtimit të ankesës, shqyrtimit të provave të administruara si dhe pas konsultimit të legjislacionit përkatës rezulton se, ankesa e Znj. \_\_\_\_\_ ndaj Prokurorisë së Përgjithshme, është e pa bazuar në ligj dhe si e tillë duhet rrëzuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”,

### V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankimit nr. 856 Prot., datë 25.05.2017 të Znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Prokuroria e Përgjithshme”.
2. Kundër këtij vendimi, ankuesi ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u dha sot me datë 27. 6 .2017.

Bësnik DERVISHI  
  
KOMISIONERI